



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 3021 Prot.

Tirane, me 09.5 2016

DEKLARATE MJEDISORE

per Vleresimin Strategjik Mjedisor

Ne mbeshetjete te Ligjit Nr. 91, date 28.02.2013 "Per vleresimin strategjik mjedisor" dhe akteve nenligjore qe rrjedhin prej tij, Ministri i Mjedisit, miraton kete Deklarate Mjedisore per:

Projekti: Plani i Integruar Ndersektorial i Zones Ekonomike Tirane-Durres

Kerkuesi: Agjencia Kombetare e Planifikimit te Territorit

Kufijte e zones qe mbulon plani: te gjitha bashkite qe preken nga brezi bregdetar (Shkodra, Lezha, Kurbini, Durresi, Kavaja, Rrogozhina, Divjaka, Fieri, Vlora, Himara, Saranda dhe Konispoli)

Perdorimi i deklarates mjedisore

Deklerata Mjedisore nuk perjashton detyrimin qe per projekte te vecanta te parashikuara ne kete Plan t'i nenshtrohen kerkesave te legjislacionit ne fuqi per vleresimin e ndikimit ne mjedis, per lejet e mjedisit dhe akteve te tjera normative ne fuqi.

Qendrimi i Ministrise:

Plani i propozuar ne parim perputhet me objektivat e mbrojtjes se mjedisit dhe zhvillimit te qendrueshem.

Plani Ndersektorial i Zones Ekonomike Tirane-Durres do te orientoje perdorimin dhe shfrytezimin e kesaj zone, si dhe do te krijojte infrastrukturen e pershtatshme per nje zhvillim te qendrueshem.

Plani do te siguroje zhvillimin e qendrueshem ekonomik te rajonit Tirane- Durres, duke mundesuar perdorim te balancuar te resurseve natyrore, infrastrukturore dhe njerezore. Per ceshtje te lehtesise se menaxhimit te procesit, rajoni eshte ndare ne kater sisteme kryesore, sipas tipareve te ngjashme territoriale, por vizioni i zhvillimit dhe politikat e hartimit te Planit te Integruar Ndersektorial te Zones Ekonomike do te jene nje umbrellë e vetme per te gjithë rajonin, dhe ç'eshte me e rendesishme, do te jene te integruara me vizionin dhe politikat e Planit te Pergjithshem Kombetar dhe Planit te Integruar Ndersektorial te Bregdetit:

Sistemi 1: Ekonomia Urbane

Sistemi 2: Turizmi dhe Natyra

Sistemi 3: Bujqesia

Sistemi 4: Infrastruktura dhe Korridoret Ekonomike

Duke realizuar nderhyrjet e duhura hapësinore dhe duke zbatuar të gjitha masat e nevojshme zbutese, të gjitha grup-projektet janë të pranueshme nga këndvështrimi mjedisor.

Perfshirja efektive e grupeve perkatese të interesit ka kontribuar në cilësinë e vlerësimit, ka sjelle të dhëna për analizën dhe raportin e VSM-se dhe do të mbështesë zbatimin e planit pas miratimit të tij, si dhe do të kontribuojë në një pranim më të lehtë dhe më të zbutur të projekteve perkatese.

Ndikimet e mundshme në mjedis të planit

Gjate zbatimit të veprimeve, priten të ndohin impakte pozitive dhe negative. Impaktet pozitive priten për ajrin dhe ndryshimet klimatike si edhe për popullatën dhe asetet materiale. Vlerësimi i rezultateve tregon se nuk do të ketë impakte mbi faktorët klimatike duke konsideruar që mjetet e transportit do të vijnë të rinovohen në të ardhmen edhe me tej, gjë që do të sjellë si pasojë përmirësim të cilësisë së ajrit dhe cilësisë së shëndetit human, midis të tjerave. Për më tej në pjesën pozitive të impakteve mbi popullatën dhe asetet materiale do të vijë si rezultat i zbatimit të infrastruktures në përgjithësi që do të bëjë të mundur pakesimin e kohës së udhëtimit, sigurinë në lëvizje, përafrimin me tregjet dhe qendrat kryesore urbane dhe shërbimet publike në përgjithësi.

Përgjithësisht, shumica e impakteve negative janë të lidhura me fazën e planifikimit (pozicionimi i infrastruktures në hapësirë dhe përgatitja e kushteve teknike të përshtatshme), pasi Shqipëria ka vecori të theksuara të ndryshme dhe të shumta nga ana natyrore, kulturore dhe peisazhi që mund të ndikohen konsiderueshëm prej zhvillimeve të infrastruktures, sidomos atyre me shtrirje të gjera dhe korridoreve sipas sektoreve (transport, energji, ujë, etj.). Impaktet negative shfaqen në fazën e planifikimit prej aspekteve të përdorimit të tokës, efekteve në ujë, natyrë (si biodiversiteti edhe zonat me status të mbrojtur), trashëgimie kulturore dhe peisazhin. Këto impakte do të kërkojnë krijimin e një programi bashkëkohor mbi masat zbutese dhe një zbatim të përshtatshëm të këtyre masave. Impakte negative mbi shëndetin human mund të ndodhin për shkak të rritjes së ndotjes nga zhurmat dhe impaktet në cilësinë e ajrit, veçanërisht në zonat me densitet të lartë banimi ku do të përqendrohen edhe një seri veprimesh në territor të ngushtë dhe kjo do të ndikojë kryesisht në fazën e zbatimit të projekteve specifike.

Perputhshmeria e me objektivat mjedisore të projekteve specifike individuale:

- Në marrëdhënie me objektivat mjedisore, të gjitha projektet specifike që lidhen me Objektiven Strategjike 1 "Përmirësimi i Cilësisë Urbane" janë të pranueshme nga pikepamja mjedisore, bile konsiderohen se do të kenë ndikime pozitive në këtë drejtim. Duhet marrë parasysh zbatimi i masave zbutese kryesisht për projektet PCU4 dhe PCU5.
- Përsa i përket Objektives Strategjike 2 "Përmirësimi i Cilësisë së Jetesës", përgjithësisht projektet janë të pranueshme nga pikepamja mjedisore; sidoqoftë niveli i nivelit i perputhshmerisë së kushtezuar këtu është i lartë, kështu që kërkohet zbatimi i masave zbutese për të këtu projektet e parashikuara për arritjen e kësaj objektivë.
- Lidhur me projektet e parashikuara për arritjen e Objektives Strategjike 3 "Zhvillimi i Qendrueshëm Ekonomik" mund të thuhet se shkalla e perputhshmerisë është e lartë. Ka projekte (PE9) që janë totalisht në përputhje me objektivat mjedisore, si dhe projekte të tjera (PE7 dhe PE10) për të cilat shkalla e perputhshmerisë së kushtezuar është

konsiderueshem e larte. Zbatimi i masave zbutese per te gjithë projekte e parashikuar perben nje detyrim thelbesor per te realizuar me sukses keto projekte dhe per arritjen e objektives perkatese.

- Dy nga projektet e parashikuara per Objektiven Strategjike 4 “Zhvillimi i Turizmit”, konkretisht PTu1 dhe PTu2 jane ne perputhshmeri te larte me objektivat mjedisore, nderkohe qe dy projektet e tjera, PTu3 dhe PTu4 kane nje perqindje te konsiderueshme perputhshmerie te pjesshme apo te kushtezuar, per shkak te ndikimeve qe priten te shkaktojne, dhe qe kerkojne zbatimin e masave perkatese zbutese.
- Persa i perket projekteve per Objektiven Strategjike 5 “Permiresimi i Infrastruktures se Transportit dhe Mobilitetit ne Rajon” duhet vene ne dukje se dy projekte, PTr12 dhe PTr13 jane plotesisht ne perputhje me objektivat mjedisore. Te gjitha projektet e tjera kane nje perqindje te konsiderueshme perputhshmerie te pjesshme apo te kushtezuar, per shkak te ndikimeve qe priten te shkaktojne, dhe qe kerkojne zbatimin e masave perkatese zbutese.
- Projektet qe parashikohen per arritjen e Objektives Strategjike 6 “Mbrojtja dhe Permiresimi i Cilesise se Mjedisit Natyror” pergjithesisht kane nje nivel te larte perputhshmerie me objektivat mjedisore. Projektet PM1, PM2 dhe PM8 plotesisht ne perputhje, nderkohe qe per projektet PM3 dhe PM9 perqindja e perputhshmerise eshte konsiderueshem e larte. Persa i perket projekteve e tjera, te cilat kane nje nivel te caktuar perputhshmerie te kushtezuar, duhet qe te aplikohen masat zbutese perkatese per te adresuar ndikimet e tyre ne mjedis.

Ndikimet kumulative te projekteve qe parashikon te zhvilloje Plani do te jepnin rezultat pozitiv ne raport me Objektivat Mjedisore, lidhur me mbrojtjen e degradimit te tokes, se pari sepse Plani pozicionohet qarte ne mbrojtje te tokes, zhvillimit urban permes densifikimit dhe integrimin urban te zonave informale dhe te marginalizuara. Ne rast se krahas zbatimit me prioritet te Legjislacionit Mjedisor dhe “best practices” nderkombetare do te aplikohen masat zbutese efektive dhe te integruara me mjedisin, masat qe do te kene impakt sidomos ne fazat e zbatimit te infrastruktures do te eliminojne ose se paku do te minimizojne impaktet permanente dhe afatgjate. Ne asnje rast projektet dhe masat nuk duhet te nderhyjne ne territorin e zonave te mbrojtura (sidomos Parqet Kombetare), sic parashikon edhe Plani. Persa i takon investimeve qe krijojne impakt ne zonat e mbrojtura dhe per me teper kur ato ndodhen brenda tyre (HEC-et, bujqesia intensive, turizmi, transporti, etj.) duhet te aplikohet me prioritet legjislacioni per zonat e mbrojtura, i cili i ndalon ato. Konsiderohet qe volumet e mbetjeve qe pritet te prodhohen nga projektet e parashikuara ne rajonin ekonomik Tirane-Durres do te kerkojne investime shtese per depozitim e mbetjeve per te minimizuar impaktet e drejtperdrejta afatgjate.

Detajimi i masave per mbrojtjen e mjedisit:

Me qellimin per te shmangur, minimizuar, kontrolluar dhe menaxhuar ndikimet negative ne mjedis te planit ne te gjithë fazat e tij duhet te zbatohen me perpikmeri te gjitha masat e meposhtme.

- Te hartohet Programi i Monitorimit Mjedisor gjate zbatimit te planit, me synim mbledhjen e te dhenave per ndikimet konkrete dhe pasojat ne mjedis gjate zbatimit te tyre, si dhe verifikimin e ndikimeve dhe marrjen e masave zbutese shtese, qe duhet te zbatohen per te garantuar mbrojtjen e mjedisit. Ky plan te hartohet brenda 6 muajve nga marrja e Deklarates Mjedisore dhe te merret miratimi i autoriteve pergjegjese per mbrojtjen e mjedisit.

- Agjencia Kombetare e Planifikimit te Territorit qe zbaton dhe mbikqyr zbatimin e planit te hartoje nje raport vjetor per masat e marra per mbrojtjen e mjedisit gjate zbatimit, te cilin duhet ta dergoje prane Ministrise se Mjedisit jo me vone se java e fundit e muajit nentor.
- Me qellim lehtesimin e realizimit te programit te monitorimit mjedisor te planit mund te perdoren programe ekzistuese monitorimi, qe perputhen me qellimin e programit te monitorimit mjedisor te planit.
- Projektimi i objekteve te bazohet ne parimin e teknologjise me te mire te disponueshme, e cila eshte efciente ne perdorimin e energjise, si perdorimi i teknologjive izotermike te ndertimit per cdo objekt te ri po keshtu edhe ato te minimizimit te perdorimit te ujit.
- Politikat dhe aktivitetet infrastrukurore te parashikuara ne Plan sigurojne kohezion, efikasitet dhe qendrueshmeri, dhe rritjen e perfitimeve per perdoruesit e kesaj infrastrukture.
- Plani duhet te nxite realizimin e projekteve te impianteve te trajtimit te ujrave te perdorur urbane dhe ne nje shkalle me te gjere duke e shtrire kete mase edhe ne aktivite e tjera industriale qe krijojne shkarkime ujrash industriale te ndotura dhe qe ndikojne sidomos ne cilesine e ujrave siperfaqesore, nentokesore dhe te ujrave bregdetare. Te projektohet infrastrukture bashkekohore dhe afatgjate te kanalizimeve te ujrave te ndotura urbane.
- Te mbrohen vlerat natyrore te zonave ne te cilat shtrihet studimi dhe te shmangen ne maksimum demtimi i siperfaqeve me vegjetacion natyral.
- Gjate fazes se projektimit dhe sidomos perpara nisjes se fazes se zbatimit te aktiviteve specifike individuale te Planit duhet te perfshihen masa qe do te lehtesojne ruajtjen e korridoreve te kafsheve migratore.
- Plani te marre masa per promovimin e transportit publik te pasagjereve dhe transportin hekurudhor kargo qe te kontribuojne ne pakesimin e shkarkimeme ne ajer.
- Te zbatohen masa zbutese per zhvillimin e infrastruktures, gjate rehabilitimit/ndertimit duhet te parashikojne edhe mbrojtjen nga ndotja e ajrit dhe zhurmat duke aplikuar „best practices“. Ne asnje rast nuk duhet te projektohet brenda, por as ne afersi te territorit te zonave te mbrojtura kur impaktet nga shkarkimet ne ajer dhe zhurmat ndikojne ekosistemet dhe habitatet e llojeve nen mbrojtje. Promovimi brenda dhe ne periferite e zonave te mbrojtura duhet te jete ngritja e infrastrukturave te lehta qe mbeshtesin aktivitetet pa makina, ne drejtim te sporteve dhe aktiviteve ne natyre.
- Hartimi i planeve te menaxhimit te trafikut krahas prioritizimit te zonave te gjelberta publike, duhet te paraprijne planet urbane te zhvillimit dhe te kene objektiva te matshme per cilesine e ajrit.
- Te merren masa per mbrojtjen dhe mos demtimin e burimeve ujore qe gjenden ne zonen ne studim.
- Ne kuader te planifikimit te menaxhimit, vemendje e vecante te kushtohet per integrimin e zonave te sigurise nga permbytjet dhe atyre ligatinore, nderkohe qe masat e pyllzimit te synojne stabilizimin e humbjeve e tokes nga permbytjet (te zbatohet duke perdorur lloje te bimesise autoktone qe i rezistojne edhe permbytjeve).
- Ne kuader te planifikimit te menaxhimit te lumenjve ne zonen Tirane - Durres, vemendje e vecante te kushtohet per menaxhimin e integruar te basenit ujqor perkates. Projektet qe kane te bejne me ujin ne perdorim te konsiderohen me kondicione kufizuese mjedisore per aq kohe sa pasigurite dhe ireversibiliteti eshte i larte. Per kete duhet te paraprihet se pari me hartimin dhe miratimin e Planit te Menaxhimit te Integruar te Basenit ne zonen ku do te zhvillohet Plani dhe ne vijim te merren masat nderhyrese perkatese.

- Konsiderohet qe volumet e mbetjeve qe pritet te prodhohen nga projektet e parashikuara ne rajonin ekonomik Tirane - Durres do te kerkojne investime shtese per depozitim dhe mbetjeve per te minimizuar impaktet e drejtperdrejta afatgjate. Elementi i impaktit te mbetjeve te parashikuara kerkon te trajtohet qysh heret ne zhvillimin e masave ne menyre integrale ndersektoriale dhe ne lidhje me menaxhimin e tokes. Keto sisteme duhet te perfshijne 3 R-te (Riciklimi, Riperdorimi, Reduktimi) si pjese e suksesshme e zbatimit ne praktike.
- Para fillimit te zbatimit te projekteve te zgjidhet ceshtja e administrimit te volumit inert qe do te gjenerohet nga operacionet ndertimore.
- Plani duhet te parashikoj kapacitete me te medha per landfillet ekzistuese dhe se pari ndertimi i landfilleve te reja teknologjike duhet te paraprij investimet ne kete sektor dhe te koordinohen ne kohe sipas rajoneve perkatatese ku do te ndodhin zhvillimet (se pari ne zonen bregdetare dhe ne qendrat primare te zhvillimit ne cdo rajon).
- Te hartohet plani rajonal te menaxhimit te mbetjeve per zonen Tirane – Durres, ku te planifikohen dhe projektohen ne menyre strategjike elementet e administrimit te mbetjeve dhe elementet urbane te administrimit te mbetjeve.
- Ne teresi, projektet specifike duhet te projektohen ne harmoni me standartet e ruajtjes se peisazhit dhe mbrojtjen e trashegimise kulturore, ku se bashku me elementet e cilesise se mjedisit te jene paresore duke aplikuar „best practices“.

Detyrime dhe sanksione:

- › Pavarsisht masave dhe rekomandimeve te kesaj Deklarate Mjedisore, gjate zbatimit te planit eshte e detyrueshme te zbatohen kerkesat e legjislacionit mjedisor ne fuqi;
- › Shfaqja e elementeve te rinj ekologjike te panjohur, ne kohen qe kjo Deklarate Mjedisore eshte dhene, sjell si detyrim rivleresimin e saj.
- › Nëse plani nuk është miratuar brenda 2 viteve nga data e miratimit të deklaratës, atëherë deklarata bëhet e pavlefshme dhe procedura e VSM-së fillon nga e para.
- › Ne rast se ministria, strukturat e saj, njesite e qeverisjes vendore apo edhe grupet e interesuara, perfshi edhe publikun, konstatojne se plani nuk zbatohet ne perputhje me vendimin per miratimin e tyre dhe nuk respektojne kushtet e kerkesat e percaktuara per mbrojtjen e mjedisit, atehere ministria njofton menjehere autoritetin pergjegjes per zbatimin e miratimin e planit dhe, sipas rrethanave, i kerkon sqarimet perkatese apo ndalimin e menjehershem te zbatimit deri ne sqarimin e situates.
- › Nëse pasojat ne mjedis e shendet, tejkalojne standartet mjedisore ne fuqi, atehere ministria i kerkon autoritetit miratues e propozues te merren masat e duhura apo te konsiderohet edhe ndryshimi i planit, me qellim qe te permbushen standartet mjedisore.
- › Per mos respektimin e detyrimeve qe rrjedhin nga kjo Deklarate Mjedisore dhe te legjislacionit mjedisor ne fuqi ka sanksione ligjore.

Lefter KOKA

MINISTRI

Zona ne studim





Lista e grup-projekteve te Planit

Objektiva Strategjike	Projekti	Kodi	
OS 1: Zhvillimi i Qendrueshem Ekonomik	Ngritja e infrastruktures per akomodimin e cluster-ave (fasoneri dhe mode, perpunimi i drurit ne zonen Nikel – Kamez / UBT, Pol Kreativ (Arti) ne Kinostudio	PE1 PE2 PE3	
	Rigjenerimi i zonave industriale (Kombinati dhe ish-uzina e autotraktoreve)	PE5 PE6	
	Projekti "Stadiumi i Ri Kombetar" dhe hapësire aktivitetesh sportive / artistike masive	PE7	
	Krijimi i nje "cluster" bujqesore qe do te sherbeje si platforme per rrjetin e fermerëve dhe investime ne infrastrukture (kanale / rezervuare / hidrovore etj, zhvillimin e dy tregjeve rajonale dhe dy pikave te grumbullimit)	PE8 PE9 PE10	
OS 2: Permiresimi i Cilesise Urbane / Rurale	Rigjenerimi i Qendres se qyteteve / fshatrave (Vore, Shijak, Sukth, Kamez, Ndroq, Maminas, Preze dhe 10 qendrave te zonave rurale) dhe Projekte Pilot (kompleks banimi miks, Kopshte Urbane per qellime "bujqesore") dhe Permiresimi i hapësirave sportive dhe per ecje dhe permeabilitetit ne njesite urbane	PCU1 PCU2 PCU3 PCU4 PCU5 PCU6 PCU7	
	Projekt Pilot per integrimin dhe urbanizimin e zonave informale (Kenete / Laknas / Kamez)	PCU8	
	Kompleks Spitalor Kombetar/ Rajonal ne Vore	PCJ1	
	Projekt Pilot per trajtimin e strehimit dhe hapësirave per komunitetet e marxhinalizuara	PCJ3	
	Projekt pilot per permiresimin e efieneses energjitike ne godina te para viteve 90'	PCJ4	
	OS 3: Permiresimi i Infrastruktures se Transportit dhe Mobilitetit ne Rajon	Rigjenerimi i hekurudhes Tirane-Vore-Durres me degezim Rinas	PTr1
Terminali i Multimodal Rajonal (Tirane, Durres, Vore)		PTr2 PTr3 PTr4	
Segmente te infrastruktures rrugore (Unaza lindore e Tiranes, Vore-Durres, Vore-Fushe Kruje - lidhja Rr. Arbrit - Fushe Kruje, Vore – Ndroq, Ndroq – Kavaje, Bajpasi Vaqarr – Arbane – Petrele, Shkozet - Porto Romano		PTr5 PTr6 PTr7 PTr8 PTr9 PTr10	
Linja model e transportit publik Tirane-Durres		PTr11	
Sistemi rrugor per levizjen me bicikleta dhe kembesore qytetas dhe pika shperndarje per bicikletat		PTr13	
OS 4: Mbrojtja dhe Permiresimi i Cilesise se		Rigjenerimi i lumenjve (Erzen, Terkuza, Lana) dhe masa per mbrojtjen nga rreziku i permbytjeve, perfshire hapësirat urbane	PM1 PM2 PM5

Objektiva Strategjike	Projekti	Kodi
Mjedisit Natyror		PM6
	Pyllezim i kodrave me rrezik rreshqitje	PM3
	Kanalizime ne zonat bregdetare (Plepat-Golem dhe Apollonia-Iliria)	PM4
	Masa per mbrojtjen nga avancimi i detit	PM7
	Projekt per riciklimin dhe Qendrat e Transferimit per ne incinerator/ landfill	PM8 PM9
	Projekt Pilot ne turizem: "Itinerar Kulturor Rajonal" (Pellumbas, Petrele, Arbane, Peze, Preze, K. Rodonit) Sportet e Aventures ("mountain bike", pergjate lumit Erzen (10 km))	PTu1 PTu2
	Zhvillimi i nje pazari historik ne Durres ku mund te tregtohen punime artizanale/ souvenir	PTu3
	Pol kulturor - Krjilimi i nje zone te re e cila do te sherbeje si pol kulturor rajonal. Vendosja e strukturave te rendesise kombetare si opera/ teater/ biblioteka/ salla koncertesh	PTu4